



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2022:095361
Datë: 30.05.2024
Numri i dokumentit: 05760097

KPPP.nr.2029/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “FORMA” Sh.p.k., me NRB:71070654, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit LPR.nr.4582/15 Sh.Q., e të cilit i përfaqëson sipas autorizimit E.S. avokat nga Vitia Rr.”...” nr.25, kundër debitorit “DINICOM” Sh.p.k., me NRB:71337413, me pronar F.R., me seli në Magjistralen Ferizaj-Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.79/22 të datës 05.04.2022, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Përparim I. Xhelili me seli në Gjilan, jashtë seancës, me datë 30.05.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “DINICOM” Sh.p.k., me NRB:71337413, ashtu që ANULOHET Urdhri përmbartimor P.nr.79/22 të datës 05.04.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Përparim I. Xhelili.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “FORMA” Sh.p.k., me datë 05.04.2022, ka lëshuar Urdhri përmbartimor P.nr.79/22 me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Para kontrata për shitblerjen e paluajtshmërisë – Banesave dhe garazhes me kompensim me numër LRP.nr.2552/2018, ref.nr.662/2018 e datës 25.07.2018, duke detyruar debitorin që në emër të shumës së mbetur nga kontrata e lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 34,200.00 euro, shpenzimet për përpilimin e propozimit në shumë prej 312.00 euro si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, aq sa do të krijohen deri në përfundim të procedurës.

Debitori ka paraqitur prapësim brenda afatit ligjor duke kundërshtuar në tërësi urdhrin, ndër të tjerash ka theksuar se vet kontrata e thotë se palët do të barazohen mes vete me fatura

dhe ky barazim ka ndodhur edhe për këtë para kontratë e po ashtu edhe për para kontratën e ardhshme. Ka shtuar se në para kontrate askund nuk citohet se kjo para kontratë ka titull ekzekutiv sipas ligjit pra është dokument përmbarues, pa ju nënshtruar ndonjë procedure tjetër, e po ashtu asnjë dispozitë e kontratës si “act en minute” nuk shihet titulli përmbarimor. I ka propozuar gjykatës që urdhrin përmbarimor ta anuloj.

Përgjigje në prapësim ka parashtruar kreditori duke kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit, ndër të tjerash ka theksuar se në prapësim thuhet se para kontrata mbi shitblerjen e palujtshmërisë si dokument nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tiparet e përmbaruesmërisë, në rastin konkret sipas dispozitave ligjore dokumentet noteriale janë dokumente të përmbarueshme. Ka shtuar se me që kemi të bëjmë me një debitor të pa ndërgjegjshëm që ka për qëllim vetëm të përfitoj nga kreditori dhe ti ik përgjegjësisë së kontraktuar. Nga të lartcekurat i ka propozuar gjykatës që prapësimi i debitorit të refuzohet në tërësi si i pa bazuar dhe të vërtetohet urdhri përmbarimor, si dhe ti rimbursoj shumën prej 312.00 euro në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimi, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar për shkaqet si në vijim:

Me nenin 21 të LPP-së përcaktohet se “*Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*” ndërsa me nenin 22, par.1, nën-par 1.3 të LPP-së përcaktohet se “*Dokumente përmbaruese janë: dokumenti noterial i përmbarueshëm në pajtim me ligjin për noterinë*”, ndërsa me nenin 26, par.1 të këtij ligji parashihet se “*Dokumenti i noterizuar është i përmbarueshëm nëse është bërë i përmbarueshëm sipas rregullave të veçanta që rregullojnë përmbarueshmërin e atij dokumenti*”, kurse me nenin 27, par.1 të LPP-së përcaktohet se “*Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”. Po ashtu me nenin 32 të Ligjit nr. 03/L-10 për Noterinë e Kosovës në fuqi në kohën e përpilimit të dokumentit noterial përcaktohet se “*Dokumenti i noterizuar dhe i përgatitur në përputhje me procedurat përkatëse është drejtpërdrejtë e*

zbatueshme, me kusht që të përfshijë dispozitat e vlefshme mandatore e të pajtuara nga palët, si dhe deklaratën e palës nga e cila kërkohet kryerja e veprimit të caktuar, me efektin që zbatimi i drejtpërdrejtë dhe i detyrueshëm i obligimit mund të bëhet në pajtim me dokumentin e noterizuar, kur të jetë mbushur afati i obligimit”.

Gjykata, nga të lartcekurat, vlerëson se dokumenti përmbartimor para kontrata për shitblerjen e palujtshmërisë – Banesave dhe garazhes me kompensim me numër LRP.nr.2552/2018, ref.nr.662/2018 e datës 25.07.2018, mbi bazën e të cilit është lejuar përmbartimi, nuk ka tipare të përmbartueshmërisë për faktin se ky dokument nuk listohet si një nga dokumentet përmbartuese mbi bazën e të cilës mund të iniciohet procedura përmbartimore në kuptim të nenit 22 të LPP-së, e në anën tjetër ky dokument nuk paraqet as dokument të besueshëm siç përcaktohet me nenin 29 të LPP-së.

Gjykata vlerëson se dokumenti Para kontrata për shitblerjen e palujtshmërisë – Banesave dhe garazhes me kompenzim me numër LRP.nr.2552/2018, ref.nr.662/2018 e datës 25.07.2018, nuk përmban deklaratën e palëve me të cilën janë pajtuar që dokumentit në fjalë t’i ipet efekt përmbartimor në rast të mos përmbushjes së detyrimeve, andaj i njëjti nuk mund të konsiderohet si dokument përmbartimor në kuptim të nenit 22, par. 1, nën-par 1.3 të LPP-së, e mbi këtë bazë, prapësimi i debitorit gjen mbështetje në nen 71, par.1, nën-par 1.1 i cili përcakton se “*Prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: 1.1. dokumenti, në bazë të cilit është marr vendimi përmbartues ose urdhri përmbartues, nuk ka titull ekzekutiv ose nuk ka tipare të përmbartueshmërisë*” andaj u vendos që urdhri për lejimin e përmbartimit të anulohet.

Gjykata vlerësoi edhe pretendimet tjera të palëve të paraqitura në prapësim dhe përgjigje në prapësim, mirëpo të njëjtat nuk ishin relevante për këtë çështje përmbartimore.

Gjykata po ashtu vlerësoj pretendimet e kreditorit paraqitur në propozim dhe përgjigje në prapësim, dhe erdhi në përfundim se pretendimet e tilla janë pa mbështetje ligjore, ngase në këtë procedurë, kjo gjykatë nuk mund të lëshohet në vlerësimin tjera të paraqitura nga kreditori, sepse të njëjtat pretendim mund të realizohet në ndonjë procedurë tjetër eventuale, e assesi në këtë procedurë, sepse kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të cilit ndalohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së dokumentit objekt përmbartimi, ashtu siç kërkohet me dispozitat e neneve 21, 22, dhe 27 të LPP-së.

Andaj, në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2029/22, datë 30.05.2024

Gjyqtari
Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.